

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0109-A0001***Paditësi /Ankuesi*

M B, Prishtinë.

Kundër:*E paditura*

N.SH. I.M.N. “Kosova”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-16-0028-C0001, të datës 11 nëntor 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.
2. Vërtetohet pika 1 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-16-0028-C0001 të datës 11 nëntor 2021.
3. Priset pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-16-0028-C0001, të datës 11 nëntor 2021 dhe hiqet pezullimi i vendosur në pikën 2 të

dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-16-0028-C0001, të datës 11 nëntor 2021.

4. Lënda nga pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-II-16-0028-C0001, të datës 11 nëntor 2021, kërkesa për përfshirjen e paditësit në listën e përfutësve të 20 % nga privatizimi i N.SH IMN “Kosova”, kthehet në shkallë të parë për gjykim.
5. Nuk caktohen taksa gjyqësore në procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 16 shkurt 2016, paditësi kishte paraqitur një padi ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. 9775/2016 të datës 8 shkurt 2016, me të cilin vendim kërkesa e paditësit ishte konsideruar se është parashtruar pasa afatit për dorëzimin e kërkesave që ishte me 13 gusht 2014.

Paditësi përmes padisë kërkonte kompensimin e pagave të papaguara për vitin 2001, 2002 dhe 2003 në shumën prej 4,680.00 euro dhe pagesën e 20%. Në padi theksohet se për shkak të privatizimit të së paditurës, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës menjëherë dhe pa dëshirën e fajin e tij. Paditësi është njoftuar se pagat e papaguara do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit, mirëpo kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe paditësi do të kontaktohej me fillimin e likuidimit. Paditësi disa herë kishte kërkuar nga e paditura që paditësit t’ia paguaj pagat e papaguara në shumën e lartcekur dhe 20% por në vazhdimësi personat zyrtar të së paditurës i kanë thënë se pagesat si kërkesa të parashtruara bëhen vetëm pasi që të filloj likuidimi. Kërkesat e paditësit janë të natyrës kreditore dhe pronësore dhe nuk mund të refuzohen si pasojë e shuarjes së afateve të caktuara. Punëtorët pa fajin e tyre dhe në mënyrë të kundërligjshme kanë mbetur në gjendje të mjeruar ekonomike dhe në këtë situatë edhe të drejtat dhe kërkesat më elementare ju refuzohen mbi baza të mashtrimeve e lajthitjeve të ndryshme.

Paditësi kësaj padie i kishte bashkëngjitur: vendimin e datës 8 shkurt 2016 të AL-së me nr. 9775/2016, formularin e parashtrimit të kërkesës jo-pronësore në likuidim të datës 4 shkurt 2016 si dhe raporte të ndërprerjes së parakohshme të punës së paditësit M B.

Me datë 22 mars 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në padi në të cilën theksohet se në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, çdo veprim gjyqësor apo administrativ dhe i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje që është subjekt i vendimit për likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, Autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Prandaj, pezullimi i procedurave në lidhje me padinë e paditësit nga kjo ndërmarrje jo vetëm që është i ligjshëm por edhe është i arsyeshëm. Andaj, trajtimi i të gjitha kërkesave nga AL krijon mundësinë që të kemi vendime të harmonizuara që të gjinden zgjidhje të kënaqshme për të gjitha palët. Agjencia deklaron se nuk merr përgjegjësi apo borxh që lidhet me asetet me mirëbesim e me këtë i referohet nenit 18 pika 1 të Ligjit për AKP që thotë “Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi që lidhet me asetet në mirëbesim dhe asetet në mirëbesim nuk mund të preken nga çfarëdo borxhi i Agjencisë. Në fund AKP konsideron se pretendimet e paraqitura në padi nuk janë të mbështetura në dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret, e këto mungesa padinë e bëjnë të paqëndrueshme. Prandaj, i propozon gjykatës që të pezullohet procedura në këtë çështje derisa N.SH është në procedurë të likuidimit ose në të kundërtën të hedhet poshtë padia e paditësit si e papranueshme ose të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur një Vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me nr.Ref.BD-65/2 të datës 7 maj 2014 dhe një Vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me nr.Ref.BD-63/12 të datës 26 mars 2014.

Me datë 11 nëntor 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-II-16-0028-C0001 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me pagat e papaguara në shumën prej 2,364.00 euro dhe kishte pezulluar procedurën në çështjen juridike kontestimore ku pala paditëse kishte kërkuar kompensimin e 20% nga shitja e aseteve të ndërmarrjes për shkak që ndërmarrja është në procedurë të likuidimit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve në procedurë dhe provave të lëndës gjykata kishte gjetur se ndërmarrja në fjalë ka hyrë në procedurë të likuidimit me 7 maj 2014. Paditësi kishte parashtruar një kërkesë me 4 shkurt 2016 për kompensimin e pagave të papaguara, ndërsa Autoriteti i Likuidimit me 8 shkurt 2016 e kishte njoftuar paditësin se afati fundit për dorëzimin e kërkesave ka qenë 13 gusht 2014 dhe kërkesa e parashtruar është parashtruar jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave. Në rastin konkret meqenëse pala paditëse kërkesën për kompensimin e

pagave të papaguara e ka paraqitur pas kalimit të afatit për dorëzimin e kërkesave, gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Sa i përket kërkesa e paditësit lidhur me kompensimin e 20% nga shitja e asetëve të ndërmarrjes gjykata kishte ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës. Andaj gjykata kishte vendosur si më lartë.

Me datë 25 shkurt 2022, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-II-16-0028-C0001 të datës 11 nëntor 2021. Në ankesë theksohet se paditësi ka dëshmuar se është punëtor i ndërmarrjes shoqërore në fjalë duke ofruar dëshmi si vërtetimi mbi përvojën e punës, përkatësisht periudhë kohore e cila vërtetohet në bazë të dokumentacionit të punës dhe konkluzioni i AKP-së në këtë rast është në kundërshtim me ligjin. Paditësi kërkon nga Kolegji i Apelit që të merren parasysh pretendimet ankimore dhe të pranohet paditësi në listën përfundimtare të punëtorëve që janë përfitues prej 20% nga privatizimi i N.SH-së sepse pala ka aplikuar dhe nuk dihet ku janë dokumentet të cilat i ka dorëzuar si ID e noterizuar, Aktvendimi nr.97 e datës 24 janar 1984 i noterizuar, Aktvendimi nr. 642 i datës 20 prill 1981, certifikata në librin Amëz e datës 12 prill 2018, kartela bankare, ekstrakti, konfirmimi bankar të cilën e vërteton në bazë të listës që janë edhe shokët e tij të punës. Andaj paditësi i propozon Kolegjit të Apelit që të aprovet ankesa e paditësit lidhur me të drejtën e tij si përfitues i të drejtës së 20% dhe të vendoset paditësi në listën e AKP-së si përfitues i 20% i Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore dhe vendimi të hyj në fuqi menjëherë. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, padinë e paditësit të paraqitur në shkallë të parë, Aktvendimin nr. 2/91 të datës 25 prill 1991, listën e përkohshme të punëtorëve të N.SH I.M.N “Kosova”.

Me datë 27 prill 2022, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë plotësuese në të cilën përveç të lartcekurave në ankesë shton se me veprimet e ndërmarra përkatësisht me vendimin e marrë nga AKP, me të cilin paditësi nuk është përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta për të përfituar 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes, i njëjti ndihet i diskriminuar me mos trajtim të barabartë të punëtorëve dhe me mos përfshirje të tij as në listën përfundimtare dhe as në vendimet me të cilat i janë refuzuar kërkesat punëtorëve tjerë si të pabazuara apo si të papranueshme si dhe me mos përfshirje as në listën fillestare duke theksuar se i njëjti në bazë të dokumenteve të dorëzuara i plotëson të gjitha kriteret për tu përfshirë në

këtë listë. Prandaj, i propozon Kolegjit të Apelit si në ankesë. Parashtrësës i kishte bashkëngjitur autorizimin për përfaqësim, një Aktvendim nr. 2/91 të datës 25 prill 1991, një lajmërim për paraqitjen në punë, raportet ndërprerjes së përkohshme për punë, listën përfundimtare të punëtorëve të N.SH në fjalë, listën e përkohshme të punëtorëve, vendimin e AL-së nr. 9775/2016 të datës 8 shkurt 2016, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, Aktvendim për ndërrimin e detyrave të punës nr.97, Aktvendim për krijimin e marrëdhënies së punës me afat të caktuar, konfirmimin bankar si dhe Ekstraktin e lindjes së paditësit.

Me datë 19 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të refuzohet apeli si i pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsvetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Paditësi me kërkesë para Autoritetit të likuidimit dhe me padi në DHPGJS-ë kundër Njoftimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN029 të datës 8 shkurt 2006 kishte parashtruar dy kërkesa dhe atë kompensimin e pagave te papaguara për periudhën kohore të viteve 2001, 2002 dhe 2003 në shumën prej 4,680.00 euro, ndërsa me kërkesën e dytë kishte kërkuar 20 % nga privatizimi i N.SH-së I.M.N “Kosova”, Prishtinë.

Nëpërmjet Njoftimit nr. PRN029 të datës 8 shkurt 2006, Autoriteti i Likuidimit kërkesën e paditësit, sipas nenit 35 të shtojcës së Ligjit për AKP-në nuk e kishte trajtuar fare për shkak se e njëjta ishte parashtruar pas afatit kohor. Afati për dorëzimin e kërkesave kreditore ishte deri më 13 gusht 2014, ndërsa kërkesa ishte parashtruar më datë 4 shkurt 2016.

Ankuesi në ankesën e saj ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe në ankesën ndaj Aktgjykimit të ankimuar nuk ka sjellë ndonjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte

vonesën e saj në paraqitjen e kërkesës, përkatësisht nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës.

Me datë 11 nëntor 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-II-16-0028-C0001 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me pagat e papaguara në shumën prej 2,364.00 euro ndërsa kishte pezulluar procedurën në çështjen juridike kontestimore ku pala paditëse kishte kërkuar kompensimin e 20% nga shitja e asetëve të ndërmarrjes për shkak që ndërmarrja që nga 7 maj 2014 është në procedurë të likuidimit.

Nga këto arsye është i saktë konkluzioni i shkallës së parë se ankuesi në bazë të nenit 37.4 nën-paragrafi 4.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, kishte dështuar që me kohë të paraqesë kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit lidhur me pagat e papaguara, andaj në bazë të kësaj dispozite ligjore kërkesat e pa afatshme duhet të refuzohen si të pabazuara. Refuzimi i kërkesës mbi bazat e cekura ligjore siç ka pohuar saktë edhe nga shkalla e parë e DHPGJS-së është në vijën e jurisprudencës të krijuar në bazë të disa precedentëve në DHPGJS, të cekur në Aktgjykimin e ankimuar.

Megjithatë, Kolegji i Apelit nuk e konsideron si veprim të drejtë pezullimin e kërkesës lidhur me kërkesën e tij, përfshirjen e paditësit në listën e përfituesve të 20 % nga privatizimi i N.SH-së në fjalë për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit.

Lista e përfituesve të 20% nuk ka lidhshmëri me procedurën e likuidimit. Ajo ka prioritet absolut ndaj çdo kërkesë tjetër. Andaj në vend të pezullimit shkalla e parë do të duhej të vendoste në meritat e çështjes dhe jo të pezullonte.

Sidoqoftë neni 10.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 parasheh që procedurat apo aktet e tilla të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të Autoritetit të likuidimit apo të Gjykatës. Në këtë kuptim Kolegji i Apelit nuk mund të lejojë vazhdimin e pezullimit duke ditur se padia ishte parashtruar qysh më 16 shkurt 2014, ndërsa procedura e Likuidimit ka filluar me 7 maj 2014. Gjykata me Aktvendimin C-II-16-0028, të datës 11 nëntor 2021, me një vonesë prej afro 7 viteve e kishte pezulluar procedurën gjyqësore në këtë çështje. Gjetur në një situatë të tillë në pritje të një Vendimi nga Gjykata, paditësi tani më ka humbur të gjitha afatet për paraqitjen e kërkesës para Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren në bazë të të dhënave nga Zyra e regjistrimit se në DHPGJS nuk gjendet asnjë lëndë aktive që i referohet paditësit dhe objektit të kontestit në fjalë. Sigurisht për arsye se paditësi tashmë kishte krijuar pritshmëri të mirëqena ligjore se Gjykata do të nxjerrë një vendim për të qoftë edhe për pezullim, por brenda një afati të arsyeshëm kohor me arsyetim se paditësit mund t'i drejtohen Autoritetit të Likuidimit. Në një situatë tillë paditësi do të kishte mundësi t'i drejtohet Autoritetit të Likuidimit në realizimin e të drejtave të veta të pretenduara. Në një rast të tillë pa fajin e tij do t'u mohohet e drejta për qasje në Gjykatë si dhe mbrojtje gjyqësore. Ky rast është i tillë.

Rrjedhimisht nga arsyet e cekura më sipër shkalla e parë gabimisht ka pezulluar çështjen lidhur me të ardhurat e 20% nga privatizimi i NSH-së për shkak të fillimit të procedurës së Likuidimit.

Në bazë të këtyre arsyeve, ankesa aprovet pjesërisht si e bazuar, vërtetohet pika 1 e dispozitivit të Aktgjykimit C-II-16-0028 të datës 11 nëntor 2021, ndërsa priset pika 2 e dispozitivit të Aktgjykimit C-II-16-0028 të datës 11 nëntor 2021 dhe lënda lidhur me këtë pjesë kthehet për gjykim në shkallë të parë tek gjyqtari përkatës.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 13.2 të vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK Nr. 01/2017, nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që punëtorët lirohen nga shpenzimet gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
